



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Rev.nr.285/20

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar kolegji, Erdogan Haxhibeqiri dhe Gyltene Sylejmani anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit F. D. nga ....., Komuna e ..., të cilin e përfaqëson i autorizuari I. K., avokat nga ...i, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson Fatime Mustafa, avokate publike Komunale në Lipjan, për shkak të kompensimit të pagave, duke vendosur sipas revizionit të paraqitur nga i autorizuari i paditësit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.1275/17, të datës 27.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.11.2020, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pa bazuar revizioni i të autorizuarit të paditësit F. D., nga fshati ..., Komuna e ..., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1275/17, të datës 27.02.2020.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.1275/17, të datës 27.02.2020, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të paditësit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, C.nr.34/14, i datë 15.09.2016, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, që të detyrohet e paditura Komuna e Lipjanit, që t`ia paguajë në emër të pagesave mujore sipas marrëveshjes me nr..., shumën prej

11.210,38 Euro, për periudhën kohore nga data 30.07.2012 deri në nxjerrjen e ekspertizës financiare të datës 30.07.2016, së bashku me kamatën e llogaritur si në ekspertizë. Për shpenzimet e procedurës gjykata e ka detyruar paditësin në lartësi prej 100.00 Euro.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqit revizion i autorizuari i paditësit për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i goditur, ndërsa kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Përgjigje në revizion nuk ka paraqit pala e paditur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të autorizuesit të paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi F. D. nga fshati ..., Komuna e ..., me datë 21.01.2014, ka paraqit padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Lipjanit, që t`ia paguajë në emër të pagesave mujore sipas marrëveshjes me nr..., shumën prej 11.210,38 Euro, për periudhën kohore nga data 30.07.2012 deri në nxjerrjen e ekspertizës financiare të datës 30.07.2016, së bashku me kamatën e llogaritur si në ekspertizë.

Gjykata e shkallës së parë në shqyrtim gjyqësor ka konstatuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se paditësi F. D. deri në vitin 1991, ka qenë në marrëdhënie pune tek ndërmarrja "K." në Lipjan, në vendin e punës si konduktor, i cili fakt vërtetohet edhe me aktvendimin nr....

Gjykata gjithashtu ka konstatuar se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi që nga viti 2000 e gjerë më datë 30.07.2012, ka qenë duke punuar në N.T.U "K." në Lipjan, e cila ndërmarrje është menaxhuar në fillim nga AKM-ja, e më pas nga AKP-ja.

Nuk ka qenë kontestuese, as fakti se paditura më datë 30.07.2012, me AKP-në ka arritur një marrëveshje mbi praninë dorëzimin e Ndërmarrjes "K." Lipjan, e cila ka kaluar në administrimin e Kuvendit Komunal në Lipjan. Sipas marrëveshjes punëtorëve të ndërmarrjes nuk u është shkëputur marrëdhënia e punës nga AKP-ja, pasi që ndërmarrja kishte

menaxhment aktiv dhe në koordinim me menaxhmentin e saj, ndërmarrja “K.” në Lipjan, i ishte dorëzuar Komunës së Lipjanit me asetët dhe obligimet e deri atëhershme.

Për lartësinë e kërkesëpadisë për periudhën kontestuese gjykata ka bërë marrjen e provës-ekspertizës financiare. Nga ekspertiza financiare ka rezultuar se lartësia e kërkesës për të ardhurat personale për periudhën 30.07.2012, deri me datë 30.07.2016, kur është nxjerrë ekspertiza financiare është 11.210.38 Euro.

Gjykata ka konstatuar se nga data 01.01.2009, në bazë të dokumentacionit dëshmohet se punëtorët e NTU “K.” në ..., nuk kanë marrë pagë në asnjë formë, mirëpo kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë, pasi paditësi nuk ka arritur që të provojë bazën ligjore për kompensimin e pagave të kërkuara, ngase paditësi nuk ka lidhë marrëveshje me të paditurën për kryerjen e ndonjë pune, e gjithashtu nuk ka ndonjë evidencë për kohën e kaluar në punë me të cilën do të vërtetohej se paditësi ka krijuar të ardhura për të cilat pretendon se i takojnë sipas ligjit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes sipas ankesës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë është i drejtë dhe i ligjshëm edhe sa i përket të drejtës materiale me referencë në dispozitat e nenit 10 dhe 55 të Ligjit të Punës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, paditësi nuk e ka provuar se me të paditurën ka lidhur kontratës të punës në formë të shkruar, me të cilën do të përcaktonte kushtet e punës, kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, si dhe lartësinë e të ardhurave personale.

Ky detyrim për paditësin që të provoj faktet mbi të cilat i mbështet pretendimet e tij rrjedhë në kuptim të dispozitave nga neni 319 paragrafi 1 i LPK-së, me të cilën përcaktohet se palët ndërgjyqësore kanë për detyrë që ti provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkimet dhe pretendimet e tyre.

Mbështetur në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë përmban arsye për faktet e konstatuara, provat e administruara dhe për bazën e refuzimit të kërkesëpadisë. Gjykata ka arsyetuar se në procedurën e të provuarit sipas propozimit të palëve ka bërë marrjen e provës me ekspertizë financiare me të cilën ka konstatuar lartësinë e kërkesës së pretenduar, mirëpo ka arsyetuar se kërkesëpadia nuk ka bazë për aprovim, nga shkakut se nuk është provuar se paditësi ka marrëdhënie të punës me të paditurën për periudhën kontestuese dhe gjithashtu nuk është provuar në bazë të një evidence se paditësi e ka kaluar kohën në punë. Në logjikën e njëjtë arsyetimi përmban edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, me vlerësim se në rastin konkret paditësi nuk ka provuar ekzistimin e marrëdhënies së punës sipas një kontrate formale si bazë për kompensimin e pagave.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta për refuzimin e kërkesëpadisë, pasi që nga gjendja faktike e konstatuar ka rezultuar se paditësi deri në vitin 1991 ka qenë në marrëdhënie pune tek ndërmarrja “K.” në Lipjan në vendin e punës si konduktor, i cili fakt ishte vërtetuar me aktvendimin nr..., e datë 14.10.1986, e po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësi që nga viti 2000 e deri më datë 30.07.2012, ka qenë duke punuar në N.T.U “K.” në ... e cila ndërmarrje është menaxhuar në fillim nga AKM-ja, e më pas nga AKP-ja, e cila sipas marrëveshjes së datës 30.07.2012, i kalon Komunës së Lipjanit me asetet dhe obligimet e deritashme.

Mbi këtë gjendje faktike të konstatuar, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, përcaktuese për refuzimin e kërkesëpadisë është fakti se paditësi pas datës 30.07.2012, nuk ka vazhduar të kryej detyrat dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës tek e paditura.

Fakti se paditësi nuk ka vazhduar t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës tek e paditura nuk i krijon bazë të njëjtit për kompensimin e pagave, pavarësisht nga ekzistimi i kontratës formale për themelimin e marrëdhënies së punës.

Sikur paditësi të vazhdonte pas datës 30.07.2012, të kryente detyrat dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës i njëjti do të kishte bazë për kompensimin e të ardhurave edhe në mungesë të kontratës formale sepse ofrimi i kontratës është përgjegjësi e punëdhënësit.

Duke qenë se paditësi nuk ka një kontratë formale me të paditurën për themelimin apo vazhdimin e marrëdhënies së punës pas datë 30.07.2012, dhe rrjedhimisht i njëjti nuk është

ftuar nga e paditura që të kryej detyrat dhe përgjegjësitë për vendin e tij të punës pas datës 30.07.2012, vlerësohet se për shkak të ndryshimit të subjektit punëdhënës, paditësit i është ndërprerë në mënyrë faktike marrëdhënia e punës për të cilën nuk ka kërkuar mbrojtje gjyqësore dhe e cila potencialisht do t'i krijonte bazë për kompensimin e pagave. Në rastin konkret nuk ekziston një vendim gjyqësor apo akt tjetër i cili do të konfirmonte kundërligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës si bazë për kompensimin e pagave.

Lidhur me zbatimin e së drejtës materiale për pjesën e arsytimit sa i përket mos ekzistimit të kontratës formale për themelimin e marrëdhënies së punës, Gjykata Supreme e pranon në tërësi arsytimin e dhënë nga gjykata e shkallës së dytë, ndërsa si bazë për pathemelësinë e kërkesëpadisë lidhur me kompensimin e pagave nga shkakun se paditësi nuk ka vazhduar të kryej detyrat dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës pas datës 30.07.2012, gjykata i referohet dispozitave nga neni 155 dhe 262 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD - Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr.3/3/1978). Në këtë rast paditësi nuk është i autorizuar që si kreditor i të paditurës të kërkojë kompensimin e pagave pasi që nuk është provuar se e paditura e ka penguar në mënyrë të kundërligjshme paditësin për fitimin e munguar-pagat.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka vlerësuar edhe marrjen e provës me ekspertizë mirëpo e njëjta nuk ka ndikim sa i përket bazës, për shkak se me ekspertizë është përcaktuar vetëm lartësia e kërkesës së pretenduar por jo edhe faktet që do të krijonin bazën për pagesën e pagave.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Rev.nr.285/20, datë 26.11.2020

Kryetar i kolegjit,

Albert Zogaj